



Duke u mbështetur në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/031 Nenin 153 dhe Nenin 154 si dhe duke u mbështetur në nenin 40.2 shkronja a) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Statutit të Komunës së Klinës Neni 40 paragrafi 2 pika 1. Me shkresën nga MMPHI- nr.prot-44593/22 të datës 15.08.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të rregullt për vitin 2022 të mbajtur me datën 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për
anulimin e vendimit 01Nr.06-27416/22 për
rekomandimin e vazhdimit të kontratave për të gjithë banuesit të cilët janë shfrytëzues të
banesave sociale.

1. Anullohet vendimi për rekomandim, që kryetari i komunës t'i vazhdoj kontratat të gjithë banueseve të cilët janë shfrytëzues të banesave sociale.
2. Vendimi 01Nr.06-27416/22 i miratuar me datë: 29.07.2022, nuk mund të prodhojë efekt juridik pas anulimit nga ana e kuvendit të komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

A r s y e t i m

Vendimi anulohet pas kërkesës së MMPHI-së për rishqyrtim, me këtë rast duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010, Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2010 nuk parashihet që kuvendi t'i rekomandoj kryetarit të komunës të bëjë vazhdimin e kontratave për shfrytëzuesit e banesave nga banuesit social.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Urbanizmit dhe mbrojtje të Mjedisit;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-33590 /2022
Klinë, me 28.09 /2022



K R Y E S U E S I,
Fadil Gashi